



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 05.02.2025

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 30.01.2025, pas shqyrtimit të parë të 'Projekt-Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025', sipas propozimit me Nr. 156, të datës 12.12.2024, të hartuar nga Grupi Punues sipas vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 137, të datës 26.11.2024, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (d), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (dh), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 9, të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës Nr. 62, të datës 16.05.2013 mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim të Projekt-Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025

1. Për aprovimin në parim për procedurën e diskutimit publik të 'Projekt-Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025'.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Plani Vjetor i Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe planit të punës për vitin 2025, është në kompetencë të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Kryetarit të Komunës dhe Drejtorateve të Komunës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorateve të Komunës dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Ali Ismaili





REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA



REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 05.02.2025

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.01.2025, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1536, të datës 12.12.2024, të Drejtorisë së Arsimit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 5, shkronja (d) të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, (Gazeta Zyrtare Nr.30/2008), nenin 20, të Ligjit për Arsimin para - universitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, (Gazeta Zyrtare Nr. 17/2011), nenin 6 paragrafi 1, 2, 3 dhe nën paragrafët 3.1, 3.2 dhe 3.3, të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit Nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues para - universitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (n), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj) të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012 mori:

V E N D I M

Për ndryshim-plotësimin e Vendimit me Nr. 88, të datës 25.06.2024 për zgjedhjen e anëtarëve të Komisioneve për rekrutimin e Drejtorëve të institucioneve edukativo arsimore në Komunën e Fushë-Kosovës

1. Për ndryshim-plotësimin e paragrafit 1.4, nën paragrafit 1.4.3 të vendimit Nr. 88, të datës 25.06.2024, për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit z. Nexhmedin Rexhepi - Zëvendës Drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët 'Mihal Grameno' - Aneksi 2 në Fushë-Kosovës, për rekrutimin në institucionin parashkollorë 'Gëzimi Yni' në Fushë-Kosovës, me anëtarin e ri z. Salih Jashanica - Drejtor i Shkollës fillore të Mesme të Ulët 'Zejnel Salihu' në fshatin Bardh i Madh.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Arsimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës dhe është pjesë përbërëse e vendimit me Nr. 88, të datës 25.06.2024.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së Arsimit, Anëtarëve të Komisionit dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Ali Ismaili

